

“ FIEK-u ofron arsimim të integruar, bashkëkohor dhe inovativ, ku praktika plotëson teorinë dhe ku zhvillohen aftësi profesionale dhe hulumtuese të standardeve më të larta.”

## Pranimet

Pranimet në Universitetin e Prishtinës bëhen nëpërmjet konkurseve publike. Çdo person i cili e ka përfunduar maturën shtetërore dhe i përmbush kriteret e përcaktuara në konkursin për studentë të rinj, ka të drejtë të konkurrojë për t'u bërë pjesë e Universitetit tonë.

## Rreth nesh

Inovacionet teknologjike janë kryefjalë e zhvillimeve në botë. Në kuadër të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike është vendi nga i cili burojnë zhvillimet më inovative. Për mbi shtatë dekada, FIEK-u ruan reputacionin e ekselencës në mësimdhënie, hulumtim dhe shërbim për komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Në kuadër të këtij fakulteti, ju do të gjeni qendrat dhe laboratorët më bashkëkohorë dhe mësimdhënësit më të përkushtuar, të cilët do t'ju ofrojnë njohuri dhe hapësirë për t'i zgjeruar horizontet tuaja.



## Kontakti

Adresa:

Bregu i Diellit, p.n. 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës

Telefoni:

+ +383(0)38 554 896

Email:

fiek@uni-pr.edu

Webfaqja

<https://fiek.uni-pr.edu>



Fakulteti i  
Inxhinierisë  
Elektrike dhe  
Kompjuterike

# Kalendari akademik

15 janar	Përfundimi i ligjëratave (semestri dimëror)
15 janar – 15 shkurt	Provimet e semestrit dimëror
15 shkurt	Dita e Universitetit të Prishtinës
16 shkurt	Fillimi i semestrit veror
31 maj	Përfundimi i ligjëratave për vit akademik
Korrik	Konkursi për studimet bachelor
Shtator	Konkursi për studimet master
15 shtator	Përfundimi i vitit akademik
1 tetor	Fillimi i vitit akademik

## Programet:

### Bachelor

Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë (180 ECTS)

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (180 ECTS)

Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike (180 ECTS)

Elektroenergetikë (180 ECTS)

## Pse n'FIEK?

- Qendra kryesore e përgatitjes së inovatorëve të rinj;
- Programet më atraktive dhe bashkëkohore;
- Diplomë që njihet ndërkombëtarisht;
- Mundësi për shkëmbime semestrale në universitete partnere në Evropë dhe më gjerë;
- Tarifa të ulëta studimi;
- Mësimdhënës me përvojë dhe eminentë në fushat përkatëse;
- Hapësira bashkëkohore, të cilat përmbushin kërkesat për kërkim shkencor dhe studim;
- Bursa për studentët me arritje të larta;
- Partneritete të shumta me tregun e punës, të cilat krijojnë mundësi për: punë praktike, vende pune dhe ngritje në karrierë;
- Të diplomuar me punësueshmëri të lartë.



### Master

Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë (120 ECTS)

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (120 ECTS)

Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike (120 ECTS)

